



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government
Ministria e Arsimit dhe Shkencës
Ministarstvo Obrazovanja i Nauke / Ministry of Education and Science

Këshilli Shtetëror për Licencimin e Mësimdhënësve (KSHLM)

THIRRJE PUBLIKE

**PËR ANGAZHIMIN E EKSPERTËVE PËR VLERËSIMIN E APLIKACIONEVE TË
PROGRAMEVE PËR ZHVILLIM PROFESIONAL TË MËSIMDHËNËSVE DHE
PUNONJËSVE ARSIMORË**

Këshilli Shtetëror për Licencimin e Mësimdhënësve (KSHLM), duke u bazuar në Udhëzimin Administrativ Nr. 12/2023 për kriteret dhe procedurat e aprovimit të programeve për zhvillimin profesional të mësimdhënësve dhe punonjësve arsimorë, veçanërisht në nenin 8 që rregullon procedurat e vlerësimit të ofruesve dhe programeve të ZHPM (Zhvillimit profesional të mësimdhënësve), si dhe në Kornizën strategjike për zhvillimin e mësimdhënësve në Kosovë, nr.090/01B, fton kandidatët e interesuar të aplikojnë për angazhim si ekspertë për vlerësimin e aplikacioneve të programeve për zhvillim profesional të mësimdhënësve dhe punonjësve arsimorë.

1. QËLLIMI I THIRRJES

Qëllimi i kësaj thirrjeje është përzgjedhja e ekspertëve vendorë për vlerësimin e aplikacioneve të programeve për zhvillim profesional të mësimdhënësve dhe punonjësve arsimorë (ZHPM). Ekspertët e përzgjedhur do të angazhohen në ekipe për vlerësimin profesional të aplikacioneve, sipas fushave dhe niveleve përkatëse të arsimit parauniversitar, brenda afatit të përcaktuar dhe bazuar në udhëzimet e ofruara nga KSHLM.

2. E DREJTA PËR APLIKIM

Të drejtë aplikimi kanë mësimdhënësit, drejtorët dhe zëvendësdrejtorët e institucioneve edukative-arsimore dhe aftësuese (IEAA), si dhe ekspertë të tjerë të fushës së arsimit, të cilët plotësojnë kriteret e përcaktuara me këtë thirrje.

3. FUSHAT DHE NIVELET PËR TË CILAT APLIKOHET

Kandidatët duhet të deklarojnë në aplikim fushën/fushat e ekspertizës dhe nivelin/nivelet e arsimit parauniversitar për të cilat aplikojnë. Kandidatët që kanë përvojë dhe ekspertizë relevante në më shumë se një fushë inkurajohen të aplikojnë për të gjitha fushat përkatëse, me qëllim të sigurimit të një përfaqësimi sa më të gjerë të ekspertizës së nevojshme për formimin e ekipeve të vlerësimit sipas fushave dhe niveleve të arsimit parauniversitar.

Në funksion të vlerësimit të programeve të paraqitura në kuadër të Thirrjes Publike për ofruesit

dhe programet e ZHPM për vitin 2026 (<https://mash.rks-gov.net/alldocuments/keshilli-shteteror-per-licencimin-e-mesimdhenesve-kshlm-ftese-per-aplikim/>), kandidatët duhet të kenë ekspertizë relevante në një ose më shumë nga fushat e mëposhtme:

1. Edukimi në fëmijërinë e hershme;
2. Mësimdhënia dhe nxënia;
3. Menaxhimi dhe sigurimi i cilësisë së IEAA;
4. Vlerësimi i nxënësve;
5. Gjithëpërfshirja në IEAA;
6. Arsimi dhe aftësimi profesional dhe arsimit të rriturve (AAPARr);
7. Zhvillimi i kompetencës digjitale.

Përzgjedhja dhe formimi i ekipeve të ekspertëve do të bëhet duke marrë parasysh fushën e ekspertizës së kandidatëve, nivelin përkatës të arsimit parauniversitar dhe natyrën e programeve që do të vlerësohen.

4. KRITERET PËR PËRZGJEDHJEN E EKSPERTËVE

Kandidatët duhet të plotësojnë dhe të dëshmojnë kriteret e mëposhtme:

- Të kenë kualifikim universitar në fushën e arsimit ose në një fushë tjetër relevante për fushën e ekspertizës për të cilën aplikojnë;
- Të kenë së paku pesë (5) vite përvojë profesionale relevante në arsimin parauniversitar dhe/ose në fushën përkatëse të ekspertizës;
- Të kenë ekspertizë të dëshmuar në fushën dhe nivelin e arsimit për të cilin aplikojnë;
- Të kenë përvojë dhe/ose njohuri relevante në zhvillimin profesional të mësimdhënësve dhe punonjësve arsimorë, përfshirë zhvillimin, zbatimin, monitorimin ose vlerësimin e programeve të trajnimit;
- Të kenë njohuri për kurrikulën e arsimit parauniversitar, politikat e zhvillimit profesional dhe sistemin e licencimit të mësimdhënësve;
- Të kenë aftësi të dëshmuara për analizë dhe vlerësim profesional, punë në ekip dhe hartim të raporteve.

Përparësi gjatë përzgjedhjes do të konsiderohen:

- Kualifikimi në nivel Master ose më lart në fushën relevante;
- Përvoja në zhvillimin, zbatimin ose vlerësimin e programeve të ZHPM;
- Përvoja në monitorim, vlerësim dhe sigurim të cilësisë në arsim;
- Përvoja e mëparshme në vlerësimin e programeve të trajnimit.

5. KONFLIKTI I INTERESIT

- Kandidatët duhet të deklarojnë çdo lidhje profesionale, institucionale, financiare ose tjetër që mund të krijojë konflikt interesi me ofruesit ose programet që janë objekt i vlerësimit.
- Eksperti nuk caktohet për vlerësimin e një aplikacioni/programi të caktuar nëse ka interes të drejtpërdrejtë ose të tërthortë, lidhje ose rrethana të tjera që mund të cenojnë ose të krijojnë perceptim të cenimit të paanshmërisë, objektivitetit dhe pavarësisë së vlerësimit.
- Konflikti i interesit me një ofertues ose program të caktuar nuk nënkupton automatikisht përjashtimin e ekspertit nga e gjithë fusha. Në këto raste, eksperti përjashtohet nga vlerësimi i aplikacionit/programit me të cilin ekziston konflikti i interesit.
- Nëse natyra ose shtrirja e konfliktit mund të cenojë paanshmërinë e ekspertit edhe në vlerësimin e aplikacioneve/programeve të tjera, KSHLM mund të vendosë për

përrjashtimin e ekspertit edhe nga këto vlerësime.

- Eksperti është i obliguar të njoftojë menjëherë KSHLM-në për çdo konflikt interesi që shfaqet gjatë procesit të vlerësimit.

6. DOKUMENTACIONI PËR APLIKIM

Për të dëshmuar përmbushjen e kriterëve të përcaktuara në këtë thirrje, kandidatët duhet të dorëzojnë dokumentacionin në vijim:

1. Formularin e aplikimit, të plotësuar dhe nënshkruar, në të cilin përcaktohet fusha/fushat e ekspertizës dhe niveli/nivelet e arsimit parauniversitar për të cilat kandidati/ja aplikon;
2. CV-në e përditësuar, me të dhëna për kualifikimin dhe përvojën profesionale relevante, përfshirë, kur është e aplikueshme, përvojën në zhvillimin, zbatimin, monitorimin, sigurimin e cilësisë ose vlerësimin e programeve për zhvillim profesional të mësimdhënësve dhe punonjësve arsimorë.
3. Deklaratën e nënshkruar për konfliktin e interesit dhe ruajtjen e konfidencialitetit gjatë procesit të vlerësimit.

Ministria/KSHLM mund të kërkojë dokumentacion dëshmuës për kualifikimin, përvojën dhe ekspertizën e deklaruar në çdo fazë të procedurës së përzgjedhjes dhe, para angazhimit konkret, kandidati është i obliguar t'i paraqesë dëshmitë përkatëse.

7. PROCEDURA E PËRZGJEDHJES DHE ANGAZHIMIT

Procedura e përzgjedhjes dhe angazhimit do të zhvillohet në përputhje me nenin 8 të UA Nr. 12/2023:

- Ministria administron dhe shqyrton dokumentacionin e aplikimeve, verifikon përmbushjen formale të kriterëve dhe përgatit listën e kandidatëve që plotësojnë kriteret, e cila i paraqitet KSHLM-së për miratim.

8. KOMPENSIMI

Ekspertët kompenzohen për vlerësimin e programit/eve. Lartësia dhe mënyra e kompensimit përcaktohen me vendim të Ministrit/Ministres, në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe UA Nr. 12/2023.

9. AFATI DHE MËNYRA E APLIKIMIT

Aplikimi mund të bëhet nga data 31.08. 2026 deri më datë 11.09.2026, ora 16:00.

Dokumentacioni i kompletuar dorëzohet në pliko të mbyllur, në Arkivin e Ministrisë së Arsimit dhe Shkencës (MASH), zyra nr. 04 (kati përdhese), brenda orarit të rregullt të punës.

Në pliko të shënohet: **“Aplikim për ekspert për vlerësimin e programeve të ZHPM – KSHLM”.**

10. DISPOZITA PËRFUNDIMTARE

Vetëm kandidatët që plotësojnë kriteret e përcaktuara në këtë thirrje dhe dorëzojnë dokumentacionin e kërkuar brenda afatit do të merren në shqyrtim.

Përfshirja në listën e miratuar të ekspertëve nuk nënkupton automatikisht angazhimin e tyre në ekipet për vlerësimin e aplikacioneve. KSHLM, nga lista e miratuar e ekspertëve, përzgjedh ekipet sipas fushave dhe niveleve përkatëse të arsimit parauniversitar, në përputhje me UA Nr. 12/2023.

Gjatë caktimit të ekspertëve do të merret parasysh shmangia e konfliktit të interesit, si dhe siguri i paanshmërisë, objektivitetit dhe pavarësisë së procesit të vlerësimit.

KSHLM mund të mos caktojë një ekspert për një aplikacion ose program të caktuar në rast të ekzistimit të konfliktit të interesit ose të rrethanave të tjera që mund të cenojnë paanshmërinë, objektivitetin dhe pavarësinë e vlerësimit.

KSHLM/Ministria rezervon të drejtën të verifikojë të dhënat dhe dëshmitë e paraqitura nga kandidatët. Në rast se gjatë verifikimit konstatohet se të dhënat e deklaruar nuk janë të sakta ose nuk mund të dëshmohen, kandidati mund të largohet nga lista e ekspertëve, në përputhje me legjislacionin në fuqi.